

PËRKUJTIME NGJARJESH DHE FIGURASH TË SHQUARA TË GJUHËSISË SHQIPTARE

BARDHYL DEMIRAJ

**GUSTAV VAJGANDI -ALBANOLOG
I SHQUAR**

(1.2.1860 — 8.7.1930)

Ndër problemet themelore të gjuhësisë sonë historike, ai i prejardhjes dhe i vendit të formimit të gjuhës shqipe e, lidhur ngushtë me të, edhe historia e dialekteve të saj u bënë objekt i diskutimeve të gjera shkencore që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe fillimi i shekullit tonë. Krahas albanologëve të mirëfilltë si G. Majeri, H. Pederseni, Gj. Pekmezi, N. Jokli etj., këto çështje në një mënyrë a në një tjetër, tërroqën vëmendjen e një numri romanistësh, si H. Shuhardi, V. Majer-Lybkeja, L. Shpiçeri etj., dhe slavistësh, si Fr. Miklosići, V. Tomasheku, K. Jirečeku etj., të cilët gjatë hulumtimit të gjuhëve romane, përkatësisht sllave të Ballkanit u befasuan nga rruga e përbashkët e evolucionit të gjuhëve ballkanike qysh nga mesjeta e hershme.

Këtë hulli studimi ndoqi me besnikëri edhe gjuhëtarë i shquar gjerman Gustav Vajgandi, i cili e nisi hulumtimin e gjuhës shqipe

nga këndi i romanistit të mirëfilltë dhe nuk u shkëput prej saj deri në fund të veprimitarise së tij shkencore.

Profesor për një periudhë 40-vjeçare në Universitetin e Lajpcigut në një kohë kur lulëzonte shkolla e gramatikanëve të rindj, ai themeloi në vitin 1893 Institutin e Gjuhës Rumune dhe u bë njëri ndër nxitësit kryesorë për krijimin e një instituti të posaçëm të studimit të gjuhëve ballkanike (1917). Është autor i punimeve të shumta shkencore që kanë si temë qendrore gjuhën rumune. Krahës saj ai studioi edhe bullgarishten e shqipen dhe mbahet me të drejtë nga kritika shkencore bashkëkohore si njëri ndër themelvënësit e krahësimit gjuhësor ballkanik. Studimet e tij u botuan si monografi të veçanta ose gjetën vend në Vjetarin e institutit të tij («Vjetar i Institutit të Gjuhës Rumune», 1884-1921, i cili më vonë mori emrin «Ballkan-Arkiv», 1921-1924). Ndërsa punimet kryesore të këtij gjuhëtari në fushë të rumanishtes dhe të bullgarishtes përmendim: «Gjuha e olimpo-vllahëve» (1888); «Vlla-ho-Meglenët» (1892); «Arumunët» (I-1894, II-1895); «Atlasi gjuhësor i krahinës dakorumune» (1909); «Fjalor bullgarisht-shqip» (1914); «Etnografia e maqedonasve» (1924) etj.

Sic shihet, veprimitaria e Vajgandit është e vëllimshme dhe e larmishme, por këtu do të ndalemi kryesisht në ato punime, ku ai merret me probleme të gjuhës shqipe, për çka është më fort i interesuar edhe lexuesi i kësaj reviste.

Vajgandi nisi të mësojë dhe të studiojë gjuhën shqipe qysh në hapat e parë të veprimitarisë së tij shkencore, në fillim me ndihmën e gramatikës së G. Majerit, dhe më pas e përvetësoi mirë atë nëpërmjet veprimitarisë praktike gjatë ekspeditave në Manastir dhe gjatkë (1889-1890). Njohja e thelluar e shqipes i dha mundësi të mbante në Universitet për vite me radhë kurse për gramatikën pëershkruese dhe historike të saj. Në këto kurse ndihej mungesa e një gramatike praktike të kësaj gjuhe, meqë ndër gramatikat shqipe me qarkullim më të madh në atë kohë, e G. Majerit (1888) dhe e Gj. Pekmezit (1909), nuk e kishin këtë synim. Kjo ishte edhe arsyaja që në verën e vitit 1909 ai ndërmori një udhëtim studimi për në Shqipëri. Gjatë qëndrimeve në Borgo-Erico (Zara-Kroaci), Durrës, Kavajë, Tiranë, Elbasan, Vajgandi mblodhi një material të pasur faktik, që mundësoi jo vetëm hartimin e kësaj gramatike,

por edhe shqyrtimin e mëtejshëm të shumë çështjeve të tjera shkencore.

«Gramatikë shqipe në dialektin e gegërishtes jugore (Durrës, Elbasan, Tiranë)», botuar në vitin 1913, mbetet, pa dyshim, veprat kryesore e Vajgandit në lëmë të shqipes. Edhe pse ishte, në radhë të parë, një manual praktik, ajo ruan vlera të veçanta si për materialin e ri dhe të pasur gramatikor, të mbledhur drejtpërdrejt nga goja e popullit, ashtu edhe për zgjidhjen e disa problemeve që shqetësonin kulturën shqiptare të asaj kohe. Kështu, pavarësisht nga titulli i veprës, qëllimi i autorit nuk ishte që të paraqiste një të folme të caktuar dialekture, por më fort një përpjekje për të afruar sa më shumë dy variantet letrare të shqipes. Këtë problem ai, sikurse më parë Gj. Pekmezi, e zgjidhi me një të folme qendrore, «e cila të ishte njëlloj e kuptueshme si për gegët, edhe për toskët. E këtë e përmbushte gegërishtja jugore, edhe pse deri atëherë ajo nuk ishte përdorur si variant letrar...» (f. 2). Kjo zgjidhje e autorit përputhej plotësisht me frymën e ideve themelore të Rilindjes Kombëtare për njësimin e gjuhës shqipe. Në gramatikën e vet Vajgandi përdori alfabetin e shoqërisë «Bashkimi».

Një vepër tjetër e rëndësishme është edhe «Fjalori shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip», që Vajgandi e botoi një vit më vonë (1914). Ky fjalor në fillim ishte menduar t'i bashkohej gramatikës, por meqë numri i fjalëve që përfshihej në të, ishte deri diku i madh, ai vendosi që t'i shtonte edhe materialin që kishte mbledhur gjatë udhëtimeve në Shqipëri, duke i dhënë në të njëjtën kohë një përdorim më praktik. Krahas kësaj, autori shfrytëzoi edhe trashëgiminë e mëparshme leksikografike, sidomos fjalorin e K. Kristoforidhit dhe të shoqërisë «Bashkimi». Prej këtyre ai mori të gatshme disa qindra fjalë, por u përpoq gjithashtu që, brenda mundësive, të jepte edhe etimonin e fjalëve. Shumica e tyre burojnë nga studimet e mëparshme etimologjike të Fr. Miklosicit e të G. Majerit, si edhe nga punimet e para të N. Joklit.

Një vend të veçantë në veprimtarinë e G. Vajgandit zënë studimet për të folmet e shqipes, sidomos të diasporës. Kështu, ai na ka dhënë të parën monografi të plotë gjuhësore për të folmen arbëreshe të Zarës në *Dialekti gegë i Borgo Ericos pranë Zarës në Dalmaci*. Në të parashtron karakteristikat fonetike dhe gramatikore të kësaj të folmeje në përqasje me të gegërishtes jugore. Ky

studim ruan vlera të veçanta edhe për të dhënat etnografike për atë popullsi, e cila po i bënte ballë «në mënyrë të habitshme» asimilit sllav.

Ndër të folmet «arvanite» të Greqisë Vajgandi u përqendrua në të folmen e arvanitëve të Athinës (*Shqipja në Atikë*, 1922), duke plotësuar në këtë mënyrë atë trashëgimi shkencore që kishin lënë K. Rajnholdi, G. Majeri, A. Kullurjoti etj. Në përshkrimin fonetik dhe gramatikor të kësaj së folmeje ai shqyrton një numër mbeturinash dialektore, të cilat nuk shfaqeshin më ose dilnin vetëm aty-këtu në dialektin toskë. Për më tepër, një pjese të këtyre dukurive u përhoq t'u gjente gjegjëse në dialektin gegë. E që këtej arriti në përfundimin se në Atikë mund të kenë emigruar jo vetëm toskë, por edhe gegë.

Në studimet e tij për shqipen Vajgandi shfrytëzoi edhe letërsinë e kultivuar. Dallojmë këtu si një arritje kulmore studimin dhe përkthimin e një pjese të «Çetës së Profetëve» të Pjetër Bogdanit (botuar në «Ballkan Arkiv», III, 1923), të cilën e cilëson si veprën më të rëndësishme dhe më të vëllimshme të letërsisë së vjetër shqipe. Në këtë studim jep edhe të dhëna dialektore me interes për të folmen e gegërishtes verilindore dhe një fjalorth të veprës së Bogdanit.

Studimi i thelluar shkencor dhe praktik i gjuhës shqipe dhe i dialekteve të saj i dha mundësi Vajgandit të ndërmerrte hulumtime edhe më të vështira, që kishin të bënин me historinë e jashtme të shqipes si gjuhë ballkanike. Është fjala këtu për shpjetgimin e një numri të madh bashkëpërkimesh gjuhësore midis shqipes dhe rumanishtes (deri diku edhe bullgarishtes), të cilat në rumanishte, si gjuhë romane, nuk shpjegoheshin dot me latinishten ballkanike. Këto bashkëpërkime, që shtrihen në të gjitha nënsistemet e gjuhës, kishin tërhequr prej kohësh vëmendjen e historianëve të gjuhëve ballkanike, por deri atëherë nuk kishin gjetur ende një zgjidhje të kënaqshme. Shkaku kryesor i pështjellimeve të krijuara qëndronte në mangësitë e të dhënave historike për popujt e Ballkanit të lashtë, si edhe në mungesat e dëshmive të hershme shkrimore për gjuhët bashkëkohore (me përjashtim të greqishtes). Këto mangësi shtoheshin më tej edhe nga disa të meta në metodën e studimit të shkollave gjuhësore historike të asaj kohe.

Në qerthullin e mendimeve të ndryshme rreth këtyre problemeve, zgjidhjet që dha Vajgandi, e rritën mjaft interesimin e botës shkencore të kohës dhe lanë gjurmë të thella në zhvillimin e mëvonshëm që morën studimet gjuhësore ballkanike. Kështu, në punimin e veçantë, *Shpërnguljet shqiptare në Transilvani* («Ballkan Arkiv», III 1927), ai i shqyrton ballas këto bashkëpërkime dhe nxjerr në pah rolin dhënës të gjuhës shqipe ndaj rumanishtes. (Krahas përfundimeve të tjera, meritë e veçantë e autorit të këtij studimi është se i shtrin këto bashkëpërkime gjatë një periudhe disa-shekullore (midis shekujve III dhe XII të e.s.). Kjo ngërthente jo vetëm kohën e formësimit të shqipes (shek. IV-VI) dhe të rumanishtes (shek. VI-VII), por shtyhej thellë, deri në kohën e gjallimit të asaj gjuhe të Ballkanit të lashtë prej së cilës ishte përfthuar gjuha shqipe dhe që kishte lënë gjurmë të thella edhe në «nënën» e rumanishtes, në latinishten ballkanike.

Cila ishte kjo gjuhë? Në ç'vend të Ballkanit ishin përfthuar marrëdhëniet e ndërsjella midis shqipes dhe rumanishtes? Këto probleme të mbetura pezull në studimet e deriatëhershme, Vajgandi i trajtoi në një radhë studimesh, sidomos në «Etnografia e Maqedonasve» (1924) dhe *A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakëve?* («Ballkan Arkiv», III, 1927). Por vështirësitë e karakterit objektiv dhe subjektiv që përmendëm, bënë që edhe përfundimet e Vajgandit të mos i kalonin caqet e hipotezës.

Studimi shkencor i gjuhëve ballkanike, i pasuruar me kërkimet në terren, e joshi Vajgandin të besonte një lidhje gjenetike më të afërt të gjuhëve ballkanike. *Popujt ballkanikë*, më shumë se një term gjeografik, u bë për të një term etnografik, aq sa ai fliste për gjuhë ballkanike si për një grup gjuhësh farefisnore, i ngjashëm me grupin e gjuhëve romane, sllave etj. Megjithëse në filim Vajgandi ishte kundërshtar i teorisë së substrateve etnike, nga fundi i jetës ai përkrahu mendimin se ngjashmëritë e mëdha midis shqipes e rumanishtes (dhe bullgarishtes) i detyrohen një substrati të përbashkët etnik, të cilin e njëson me trakishten. Në këtë hulli ai ndërtoi një tezë të pambështetur lidhur me prejardhjen

e gjuhës shqipe. Sipas kësaj shqiptarët janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të trakëve. Duke e çuar më tej këtë pikëpamje, Vajgandi bëri të vetën dhe u përpoq të përforconte tezën e Rëslerit lidhur me vendin e formimit të shqipes dhe të rumanishtes. Sipas kësaj teze ato janë formuar në trekëndëshin gjeografik Nish-Sofje-Shkup; shqipja pikërisht në trevat e atëhershme të Dardanisë dhe të Moezisë Perëndimore. Në këto treva ai mendon të jenë formuar marrëdhëni e ndërsjella shqiptaro-rumune, të cilat vijuan, sipas tij, deri në shekujt XI-XII, kur shqiptarët u shtrinë në trojet e sotme, ndërsa rumunët u shpërngulën në veri të Danubit.

Megjithëse hipoteza e Vajgandit ka meritën që problemin e burimit të gjuhës shqipe e shtroi mbi një bazë më të gjërë, duke e shikuar në pamjen ballkanike dhe duke e shqyrtuar jo vetëm nga ana e gjuhës, por edhe në këndvështrimin etnografik, nga studimet e mëvonshme u vërtetua se ishte fare e pathemeltë. Së pari, nuk ka asnjë bazë historike për t'i lidhur shqiptarët me fisin e besëve dhe për të mos i njohur trevat e sotme të shqiptarëve si të banuara vijimisht nga stërgjyshërit e tyre e pastaj prej vetë shqiptarëve. Së dyti, nëpërmjet një numri studimesh shkencore, ku daloohen ndihmesat e albanologëve të shquar N. Jokli, V. Cimohovski, V. Katiçiçi etj. dhe të gjuhëtarëve shqiptarë E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, u vërtetua katërcipërisht se emërtimet gjeografike të trevave të banuara nga shqiptarët e sotëm madje edhe shumë nga të trevave kufitare me to kanë kaluar nëpër gojën e shqiptarëve, çka çon në pikëpamjen e mëparshme shkencore, të shprehur qysh prej J. Tunmanit, që shqiptarët janë rrënjos në trojet e tyre, shqipja është pasardhëse e ilirishtes dhe marrëdhëni shqiptaro-rumune janë zhvilluar në ato treva që mendonte Vajgandi, por që përbën kufijtë më verilindorë të popullsisë ilire dhe shqiptare.

Në qoftë se përfundimet që arriti Vajgandi për prejardhjen dhe vendbanimin e hershëm të shqiptarëve, ishin të gabuara, të dhënat e mbledhura nga ky njohës i mirë i gjuhëve ballkanike dhe hulumtues i zellshëm i toponimisë mbeten një trashëgimi shkencore me vlerë. Ato u dhanë nxitje kërkimeve shkencore të mëvonshme, të cilat çuan në krijimin e një disipline të re gjuhësore, të gjuhësisë ballkanike. Është shumë domethënës fakti që themeluesi i kësaj disipline, Kristian Sandfeldi, ishte nxënës i tij.

Portretin e G. Vajgandit si romanist i shquar dhe balkanolog e plotësojnë vetitë e tij morale si përparimtar demokrat. Vajgandi punoi dhe jetoi në një kohë, kur popujt e Gadishullit Ballkanik që ndodheshin nën zgjedhën turke, po zhvillonin një luftë të ash-për çlirimtare. Vepra e tij, përveç vlerave gjuhësore dhe etnografike, zgjoi edhe një interes të madh kombëtar dhe shoqëror. Duke treguar kushtet e vështira, në të cilat jetonin popujt e Ballkanit, Vajgandi i dha luftës së tyre një mbështetje morale, nëpërmjet popullarizimit të çështjes së tyre në rrëthet e gjera të opinionit shoqëror evropian të asaj kohe.